

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Reforma territoriale, Këshilli Bashkiak i Shkodrës jep pëlqimin! PD voton kundër, debate edhe për statusin e Dukagjinit dhe Velipojës (VIDEO) - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/reforma-territoriale-keshilli-bashkiak-i-shkodres-jep-pelqim-in-pd-voton-kunder-debate-edhe-per-statusin-e-dukagjinit-dhe-velipojes
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 11:13:17 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 11:09:39 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3e1b54cc9df2d8bdc99fa30ff2c185de27d1fd707fbc228f5924356e8dbf5ec0
TEKSTI	759e45ff27530acac053c7b411bfb9ef346ac692b8d1ef00786523f7ef135c9b
PAMJA	3b541ca087c616afae8e964dcffac8b7325e7d070e55d7690537a79217cde84b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b6e1305505f190e994ad534130ab9ee0f827b7581abfda3b477425529a6df397
E MËPARSHMJA	5ac9e66da26ed50e1d5764e6c3df65f46d48c3c8bc5037358a29fbad97f96790
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b6e1305505f190e994ad534130ab9ee0f827b7581abfda3b477425529a6df397>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Report Tv siguron videon e eliminimit të Tanit të Ruzhdiut në Sarandë! 44-vjeçari ia mbath pasi qëllohet, autori me skafander i vihet pas dhe i shkrepi armën në kokë

Sociale

Reforma territoriale, Këshilli Bashkiak i Shkodrës jep pëlqimin! PD voton kundër, debate edhe për statusin e Dukagjinit dhe Velipojës (VIDEO)

Dhënia e pëlqimit u miratua me 28 vota e PS dhe PSD sepse PD e kundërshtoi duke mos qenë dakord....



Ergys Kavaja

25 Shtator, 13:04 | Përditësimi: 25 Shtator, 13:46

f Share Tweet

A A

Këshilli i Bashkisë [Shkodër](#) ka miratuar dhënien e pëlqimit për ndryshimet në reformën e re territoriale. Bashkia Shkodër nga ana e saj do të qëndrojë në kufijtë aktual duke mos patur bashkim apo shkrirje të njëjse. Dhënia e pëlqimit u miratua me 28 vota e PS dhe PSD sepse PD e kundërshtoi duke mos qenë dakord....



"Projektligji duhet trajtuar i plotë, jo diku duam ta lexojmë e diku s'duam ta lexojmë. Ky vendim nuk i përket Këshillit Bashkiak Shkodër të japë një vendim të plotë. Pëlqimi për projektligjin më thotë që duhet të shkrij bashkinë Libohovë. Refuzoj të jap një mendim për Libohovën." tha Imeld Sokoli Anëtar i Këshillit Bashkiak nga rradhët e PD-së



"Praktikisht nga Velipoja deri në Theth ka nevojë për një rishikim për mënyrën si funksionon. Ky territor nuk mbulohet në mënyrë të njëtrajtshme me shërbime. Nëse voton për kryeministrin ke dhe fonde" tha Florjan Bjanku anëtar i Këshillit Bashkiak, PD

[Sh]
.com



LEXO EDHE:
PD depoziton në Kuvend draftin për ndarjen territoriale: 100 bashki dhe 12 qarqe, më shumë shërbime dhe autonomi lokale



"Po i bën shërbim Partisë Socialiste. Po hedh në votim këtë propozim. Nuk është normale" tha Irena Shestani anëtare e Këshillit Bashkiak, PD

Kryetari i Këshillit Bashkiak Oltion Luli hodhi poshtë akuzat e opozitës...



"Ky projektligj nuk ka ardhur nga [partia socialiste](#) por nga Kuvendi. Deputetët e PD nuk kanë sjellë asnjë projektligj për të diskutuar. Ne nuk prekemi nga ndryshimi i kufijve. Ka një riorganizim të brendshëm. Ndryshon skema në bashki, qytet dhe njësi administrative" tha Luli.

Një debat u krijua mes këshilltarëve edhe për Dukagjinin dhe Velipojën që marrin statusin qytet nga njësi administrative që janë deri më tani.



"Konceptimi si qytet është njësi urbane, por që të kalojnë në qytet njësi që kanë karakteristike rurale lë vend për interpretim. Në këtë rast duhej gjetur një formë tjetër" tha Florjan Bjanku, anëtar i Këshillit Bashkiak, PD



"Ku do të dalësh? Njerëzit e Dukagjinit janë njerëz si puna juaj. Ki kujdes kur flet. Nuk e pranoj. Krahina e Dukagjinit ka meritat e veta që nuk i cakton asnjë këshilltar këtu" tha Fatmir Vojvoda, anëtar i pavarur i Këshillit Bashkiak

Disa prej këshilltarëve të PS dhe PSD edhe pse e votuan pro dhënien e pëlqimit për reformën territoriale kërkuan disa ndryshime në këtë projektligj.

Pavarësisht debateve dhe kundërshtive të opozitës, Këshilli i Bashkisë Shkodër e miratoi dhënien e pëlqimit për reformën e re territoriale bashkë me propozimet përkatëse që do t'i shkojnë Kuvendit për shqyrtim të mëtejshëm.



Sa e vlerësoni këtë artikull? ★ ★ ★ ★ ★ ★ ★ ★ ★ ★ 1.5 / 5 (2 vlerësime)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

© Ndalohej repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH
COM**Sondazhi i ditës:**

22 Shtator, 16:08

Arrestimet e fundit nga SPAK, a janë provë e pavarësisë nga politika?

Po Jo Disi

Lajme të tjera

**Aksident në aksin Lezhë-Shkodër, taksia përplasjet me furgonin me mësues! 3 të plagosur**

25 Shtator, 15:06

**Territorialja, Këshilli i Tiranës kërkon Veliain në mbledhjen e 29 shtatorit! Shkresë SPAK dhe Burgjeve: Lejojeni fizikisht ose me videokonferencë**

25 Shtator, 13:34

**Hemodializa sërisht privatit, anulohet tenderi 50 milionë euro! Agjencia e Prokurimit Publik: Gabime dhe mangësi në dokumente**


25 Shtator, 12:54

**Territorialja/ Nga aktorë te avokatë e shkrimtarë kundër shkrirjes së bashkisë së Patosit dhe bashkimit me Fierin! Letër drejtuar Kuvendit**

25 Shtator, 08:41

**'Territorialja'/ Këshilli Bashkiak Elbasan jep 'Ok' bashkimit me Cërrikun dhe Belshin (VIDEO)**

24 Shtator, 19:56

**Avokatët njoftuan se GJKKO urdhëroi SPAK për nisjen e hetimeve për resortin e Ulajit në Rrjoll, Prek Molla: Lajm i mirë! Paralajmëroj shqiptarët që të mos blejnë në 'Baks Bay', s'do i gëzojë askush pronat tona**

24 Shtator, 19:40

**Tym i dendur mbulon aksin Lezhë-Shkodër, zjarret në të dy anët e rrugës rrezikojnë qarkullimin (VIDEO)**

24 Shtator, 16:46

**Art dhe humor, 'Shkodra ka plot dashuri' vjen në teatrin 'Migjeni' për pesë netë radhazi** **Ergys Kavaja**

24 Shtator, 15:25

**Reforma territoriale, Prrenjasi i thotë 'jo' bashkimit me Librazhdin! Asnjë votë pro në Këshillin Bashkiak (VIDEO)**

24 Shtator, 12:06



Dyshohet se kultivoi 143 bimë kanabisi në Vilës të Vaut të Dejës, arrestohet 50-vjeçari (VIDEO)

24 Shtator, 11:15

Resorti luksoz i Bashkim Ulajt në Rrjoll, avokatët: GJKKO urdhëroi SPAK të nisë hetimet! Banorët pretendojnë se tokat iu vodhën me dokumente false

23 Shtator, 16:22

Territorialja, nis me sherr te Komisioni i Ligjeve! Opozita braktis sallën: Kthejeni draftin, duhet konsensus



Isa Myzyraj

23 Shtator, 11:27

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

Puno me ne

[Shqiptaria.com]

Kërko



© 2011 - 2026 Shqiptaria.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.